



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:103805

Datë: 20.12.2023

Numri i dokumentit: 05096927

C.nr.1237/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoresh profesionale H.D. në çështjen juridiko kontestimore të paditësit V.P. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson E.G. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës I.A. nga fshati komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson A.R. avokat nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 4,950.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - publik, në prezencë të paditësit dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 23.11.2023, mori, ndërsa më datë 20.12.2023, përpiloi me shkrim, këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit V.P. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “*I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.P. II. OBLIGOHET e paditura Ilirjeta Pireci, nga fshati Sallagrazhdë, komuna e Suharekës, që paditësit t’ia kompensoi:*

A. Dëmi material

- Në emër të shpenzimeve të ushqimit shumën prej 1,200 euro.
- Në emër të muzikës shumën prej 300 euro.
- Në emër të tupanëve shumën prej 500 euro.
- Në emër të aparatit të kafes shumën prej 150 euro.
- Në emër të propozimit për martesë shumën prej 600 euro.
- Në emër të rregullimit të dokumentacionit shumën prej 200 euro.

B Dëmi moral

- Në emër të dhimbjeve psikike shumën prej 2,000 euro

Si shumë totale 4,950 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, që nga dita e shkaktimit të dëmit”, si e pabazuar.

II. OBLIGOHET paditësi, që në emër të shpenzimeve procedurale t’i paguajë të paditurës shumën prej 306.50 € (treqind e gjashtë euro e pesëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi V.P. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij E.G. avokat nga Prizreni, me datën 27.08.2020, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, ndaj të paditurës I.A. nga fshati komuna e Suharekës, të cilën me autorizim e përfaqëson A.R. avokat nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 4,950.00 €.

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësit, në padinë e paraqitur ka theksuar se palët ndërgjyqëse kanë qenë të fejuar dhe të martuar dhe zgjidhjen e martesës e kanë bërë pranë Gjykatës Themelore në Prizren, në çështjen kontestimore C.nr.1267/2019, të datës 13.07.2020. para martesës është bërë fejesa sipas traditave vendore ku është bërë edhe ceremonia e fejesës, me të ftuar të shumtë dhe janë krijuar shpenzime të shumta. Në këtë ceremoni paditësi ka shpenzuar shumta të mëdha, ka pasur të ftuar rreth 200 persona, ka pasur muzikë, tupanat dhe aparati i kafes. Po ashtu pas fejesës është rezervuar edhe fotografi së bashku me produksion duke shpenzuar shumën prej 600 euro. Tutje ka shtuar se paditësi ka shpenzuar po ashtu me rregullimin e dokumentacionit pasi që e paditura jeton jashtë shtetit. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar.

I autorizuari i paditësit edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave e sidomos me dëgjimin e paditësit në cilësi të palës në tërësi u vërtetua pretendimet e kësaj padie ku e paditura ka qenë shkaktare drejtë për drejtë për krijimin e shpenzimeve me rastin e fejesës nga se qëllimi ka qenë që të lidhet edhe martesë e cila është lidhur, mirëpo për shkak se e paditura ka krijuar një lidhje tjetër ka ardhur deri te zgjidhja e martesës me vullnetin e saj dhe kërkesën e saj. Si pasojë e kësaj rrethane ka ardhur deri te zgjidhja e martesës, është tentuar që përmes familjarëve, që familja e të paditurës të i paguaj – kompensoj të gjitha shpenzimet e krijuara për ahengun familjar dhe dëmshpërblimin për prishjen e martesës dhe ndryshimin e statusit nga beqar në të shkurorëzuar. Nga këto baza konsideron se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që gjykata të obligojë të paditurën që të ia paguaj shpenzimet e krijuara për aheng familjar dhe dëm moral nga se është një fakt i vërtetuar me administrimin e provave.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 414.00€, të specifikuar në fjalën përfundimtare.

E paditura përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur përgjigje në padi, duke theksuar se nga aktgjykimi C.nr.1267/19, shihet se kemi zgjidhje të martesës me marrëveshje-kemi pajtimin e bashkëshortëve, nuk kemi kontest në zgjidhjen e fejesës-marteses, e cila nuk është finalizuar me bashkëjetesë. Me rastin e prishjes së martesës, pala e paditur-familja e saj i kanë kthyer të gjitha dhuratat nga fejesa me datë 22.07.2020. Pretendimet e paditësit se ka shpenzime dhe dëm material nga fejesa të krijuar me kërkesën e të paditurës nuk qëndrojnë, pasi e paditura nuk ka shkaktuar dëm moral, meqenëse edhe vet ka përjetuar këto rrethana të shkaktuara me fajin e paditësit. Prishja

e raporteve bashkëshortore ka ardhur si shkas i veprës penale ku paditësi është gjykuar sipas aktgjykimit P.nr.330/2019, të datës 28.01.2019. Në fund gjykatës i ka propozuar kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pabazuar.

Edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari e të paditurës ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigjen në padi, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara mund të provohet se shkak i prishjes së martesës është aktgjykimi penal i dorëzuar, ku e paditura I.A. nga ky moment ka shkëputur kontaktin me paditësit V.P. Edhe Ligji mbi Familjen e rregullon si kusht për prishjen e martesës mund të jetë edhe vepra penale kundër bashkëshortit siç është e rregulluar me nenin 69 të LMF. Paditësi pretendon se ju kanë shkaktuar shpenzimet nga fejesa por të njëjtat nuk janë të argumentuara me prova dhe shpenzimet të cilat janë shkaktuar nga fejesa janë kthyer të njëjtit sipas procesverbalit të datës 22.07.2020. Edhe LMD e rregullon faktin se kush do që shkakton dëm vetit me fajin e tij nuk mund të kompensohet. Andaj konsiderojmë se e paditura nuk është shkaktare e prishjes së martesës dhe nuk i ka shkaktuar shpenzimet materiale palës paditëse. E paditura për shkak të gjinisë femërore e njëjta ka humbur privilegjet si beqare pasi që konsiderohet se ka qenë e martuar dhe tani është e shkurorëzuar. Në fund gjykatës i ka propozuar që në kuadër të këtyre pretendimeve ligjore si dhe mungesës së provave padinë e paditësit të refuzon në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 374.00 €, të specifikuar në fjalën përfundimtare.

2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: dëgjimi i paditësit V.P. në cilësi të palës; aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren me numër C.nr. 1267/2019, i datës 13.07.2020; aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren –Dega në Suharekë P.nr. 330/19 i datës 28.01.2020; procesverbali mbi kthimin e dhuratave nga fejesa e përpiluar më datë 22.07.2020, së bashku me fletën e cila është bashkangjitur për kthimin e gjësendeve; aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër PA1.nr. 430/2020 i datës 22.09.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit **është e pabazuar.**

Gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 23.11.2023, ka bërë dëgjimin i paditësit V.P. në cilësi të palës, i cili ka deklaruar: “se fillimisht me këtu të paditurën I.A. janë fejuar sipas traditës, me rastin e fejesës kemi bërë aheng familjar, ku në këtë aheng familjar kemi pasur muzikë, daulle (tupanat), ku kanë qenë pjesëmarrës deri në 350 persona”. Në pyetjet e parashtruara nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse i njëjti ka deklaruar se shpenzimet për ahengun familjar kanë qenë muzika 1000 euro, tupanat 500-600 euro, si dhe menyja për 350 veta dhe se nga familja e ish bashkëshortes së tij ka kërkuar dëmshpërblimin për shpenzimet e realizuara por të njëjtit nuk

kanë pranuar që të flasin. Tutje ka deklaruar se në këtë aheng nuk kanë qenë prezent askush nga familja e këtu të paditurës. Ndërsa sa i përket shpenzimeve për këtë aheng nuk ka ndonjë provë ose faturë.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren me numër C.nr. 1267/2019, i datës 13.07.2020, gjykata vërtetoi faktin se këtu palët ndërgjyqëse sipas propozimit të përbashkët e kanë zgjidhur martesën e lidhur me datë 30.04.2019, në Prizren.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren –Dega në Suharekë, me numër P.nr. 330/19, të datës 28.01.2020, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi është shpallur fajtor për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.1 të KP-së dhe është dënuar me gjobë. Ndërsa e dëmtuar në këtë rast është këtu e paditura I.A.

Nga leximi i procesverbalit mbi kthimin e dhuratave nga fejesa e përpiluar më datë 22.07.2020, së bashku me fletën e cila është bashkangjitur për kthimin e gjësendeve, gjykata vërtetoi faktin se e paditura ia kishte kthyer gjësendet nga fejesa këtu paditësit.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës me numër PA1.nr. 430/2020, të datës 22.09.2020, gjykata vërtetoi faktin se ishte refuzuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren –Dega në Suharekë, me numër P.nr. 330/19, i datës 28.01.2020.

3. Baza Ligjore

Neni 136 i Ligjit të Marrëdhënive të Detyrimeve, në par.1 të tij përcakton se: “*Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij*”, neni 137 i po këtij ligji përcakton: “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).*”, neni 140 i këtij ligji përcakton: “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkakuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia*”.

Në nenin 11, par.1, të Ligjit të Familjes së Kosovës, është përcaktuar se: “*Nëse personi i fejuar heq dorë nga fejesa, ai është i detyruar të paguajë për çdo dëm të shkakuar të fejuarit tjetër ose prindërve të të fejuarit tjetër apo personave tjerë të cilët kanë vepruar në emër të tyre. I fejuari është përgjegjës për çdo shpenzim apo detyrim të investuar në pritje të martesës. Ai është po ashtu përgjegjës për shpenzimet apo detyrimet që i fejuari tjetër i ka bërë në pritje të martesës, pra ato të cilat ndikojnë në punësimin apo pasurinë e tij*”.

4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara më lartë në lidhje me këtë çështje kontestimore dhe dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi dhe e paditura kanë qenë të fejuar, të njëjtit janë martuar me datë 30.04.2019 dhe se me aktgjykimin me shenjën C.nr. 1267/2019, të datës 13.07.2020, sipas propozimit të përbashkët e kanë zgjidhur martesën me shkurorëzim.

Gjykata, vlerëson se në këtë çështje kontestimore, baza juridike e kërkesëpadisë nuk gjen mbështetje në nenin 136 par.1 dhe 140 të LMD-së, për arsye se dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jetë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Nga vetë përmbajtja e nenit 136 par.1 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka për detyrim t'ia shpërblejë atë. Për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme që të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia deliktore dhe e) të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në rastin konkret nuk janë plotësuar parakushtet ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit këtu paditësit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të fakteve të cilat i kemi cekur me lart, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar në ligj dhe në fakte. Pretendimi i paditësit se e paditura i ka shkaktuar dëm material dhe jo material (moral), në lartësi prej 4,950.00 euro, mbetet si fakt i pa provuar për gjykatën. Ngase në bazë të provave të ofruara, gjykata nuk ka arritur që ta vërtetojë se e paditura i ka shkaktuar dëm këtu paditësit. Paditësi gjykatës nuk ia ka prezantuar asnjë provë materiale me të cilën do të bazonte pretendimet e tij, e në kuptim të nenit 7, par.1 të LPK-së është papapararë që *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* ndërsa neni 319.1 parashihet që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, mbi këto baza ligjore barra e provës bie mbi paditësin, andaj është obligim i paditësit që gjykatës ti provoj se i njëjti ka pësuar dëm nga ana e paditëses dhe se sa është lartësia e atij dëmi që pretendon ta ketë pësuar.

Ndër të tjera me nenin 11, par.1, të Ligjit të Familjes së Kosovës, është përcaktuar se: *“Nëse personi i fejuar heq dorë nga fejesa, ai është i detyruar të paguajë për çdo dëm të shkaktuar të fejuarit tjetër ose prindërve të të fejuarit tjetër apo personave tjerë të cilët kanë vepruar në emër të tyre. I fejuari është përgjegjës për çdo shpenzim apo detyrim të investuar në pritje të martesës. Ai është po ashtu përgjegjës për shpenzimet apo detyrimet që i fejuari tjetër i ka bërë në pritje të martesës, pra ato të cilat ndikojnë në punësimin apo pasurinën e tij”*, e në rastin konkret gjykata e ka vërtetuar faktin se palët ndërgjyqëse kanë lidhë martesë dhe në momentin e lidhjes se martesës, të gjitha pretendimet eventuale për shpërblimin e dëmit apo shpenzimeve lidhur me fejesën nuk paraqesin ndonjë efekt juridik ngase me lidhje të martesës është arritur qëllimi i fejesë duke u bazuar në nenin 9 të LFK-së ku parashihet që: *“Fejesa është*

premtim reciprok i dy personave me gjini të kundërta për t'u martuar në të ardhmen". E bazuar në shkresat e lëndës, deklarimi i paditësit, si dhe aktgjykimi C.nr.1267/2019, gjykata vërtetoi faktin se paditësi me të paditurën me datë 30.04.2019, janë martuar, të cilën martesë e kanë zgjidhur me shkurorëzim, përmes propozimit të përbashkët.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Për pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, në të cilat janë përfshirë, përpilimi i përgjigjes në padi në shumë prej 104.00 €, për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumë prej 135.00 € dhe për një seancë të shtyrë shumë prej 67.50 €, apo shumë e përgjithshme prej 306.50 € (treqind e gjashtë euro e pesëdhjetë cent). Pjesën tjetër të kërkesës së të paditurit që të detyrohet paditësi të paguaj shpenzimet procedurale përtej shumës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e vlerësoi si të pabazuar, pasi që seanca e datës 08.11.2023, nuk është mbajtur, e njëjta është shtyrë me kërkesën e paditësit andaj edhe shpenzimet për këtë seancë ia njohu pjesërisht.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenet 136 par.1, 137 dhe 140, të LMD-së, neni 11 par.1 të LFK-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1237/2020, datë 20.12.2023

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.